

USHQYES KRISTALOR ME PERMBAJTJE TË LARTË
POTASI ME MIKROELEMENTE TË ÇELATUAR ME EDTA



5 POUNDS
2.27 KG



AZOT TOTAL(N)	4.0%	Bor (B)	0.02%
NO3:	4.0%	Bakër (Cu)	0.05%
FOSFOR(P2O5)	5.0%	Hekur (Fe)	0.10%
POTAS(K2O)	40.0%	Mangan (Mn)	0.05%
Magnez(Mg)	2.0%	Molybden(Mo)	0.0005%
Squfur(S)	10.0%	Zink (Zn)	0.05%

PRODHUAR & PAKETUAR NË
SHTETET E BASHKUARA TË
AMERIKËS NGA



HANOVER, PENNSYLVANIA
17331 U.S.A.

“EC FERTILIZER”

Makronutrientet (NPK) derivojnë nga Potassium Nitrate, Potassium Phosphate and Potassium Sulfate.

Mikronutrientet : Magnesiumi derivon nga Magnesium Sulfate. Sqfuri derivon nga Potassium Sulfate and Magnesium Sulfate.

Bakri, Hekuri, Manganezi, Zinku janë teresisht të Çelatuar me EDTA Chelate (Disodium Ethylenediamine Tetra Acetate Chelate).

Bori derivon nga Sodium Borate. Molybdeni derivon nga Ammonium Molybdate.

PERDORIMI : NUTRI-LEAF 4-5-40® është një ushqyes gjethor dhe rrenjor me përqendrim të lartë të Potasit. Përdoret në programet e ushqimit në kulturat bujqësore në ato faza fenologjike kur Potasi kërket në sasi të konsiderueshme për të garantuar hereshmerinë në pjekje, qëndrueshmërinë ndaj patogjeneve para dhe pas vjeljes, për të siguruar sasi dhe cilësi të lartë të prodhimit. Përdoret gjithashtu për kurimin e shpejtë të karencës kur konstatohen shenjat e mungesës së Potasit.

DOZAT E PERGJITHESHME TE PËRDORIMIT: Në ushqimin gjethor përdoret 200-400 gr/100 lit. uje. Në rastet e trajtimeve me pompe shpine përdoret 6 gram për një liter uje. Shtohet NU-FILM për të siguruar uniformitetin dhe ngjiteshmërinë të solucionit përkatës në masën e gjelbër. Në ushqimin rrenjor me ujitje me pika përdoret 2-4 Kg/dynym.

KOHA, NUMRI I TRAJTIMEVE DHE SHPESHTIA E TYRE : Përdorimi si ushqyes gjethor kryhet sa herë që konstatohet karenta të Potasit në bimë. Në përgjithësi rekomandohen 4-5 trajtime për sezon duke filluar me rritjen maksimale të frutit dhe duke i perseritur trajtimet në intervalin 7-10 dite. Numri dhe shpeshtia e trajtimeve është në vartësi të nevojave për Potas, ndjeshmërisë së kulturave ndaj këtij ushqyesi, të kushteve klimatike dhe streseve të ndryshme (mungesa e lageshtisë në tokë, temperaturat e larta, rreshjet e dendura dhe probleme fitopatologjike) të cilat mund të zvogelojnë aftësinë e sistemit rrenjor në thithjen e Potasit. Trajtimet gjethore mund të kombinohen me trajtimet me fungicide dhe insekticide. Në sistemet e ujitjes me pika **NUTRI-LEAF 4-5-40®** përdoret në të njëjtën kohë dhe frekuencë.

PERDORIMI SIPAS KULTURAVE :

NE PERIME (Domate, Specat, Patllixha, Pjepër, Kungull, Shalqi, etj.): **Si ushqyes gjethor** : Përdoret me dozë 200-400 gr/100 lit. uje. **Me ujitje me pika** : Norma e përdorimit është 2-4 kg/dynym. **NE PATATE**: Është bimë me kërkesa ndaj Potasit, prandaj programi i ushqimit gjethor me **NUTRI-LEAF 4-5-40®** fillon 60-70 ditë pas mbjelljes, e cila është periudha intensive e lidhjes së tubereve duke nxitur lidhjen dhe tejkalimin e stresit fiziologjik të lidhjes si dhe ato klimatiko tokësore në këtë periudhë kritike të bimesës. Rekomandohet të kryhen 3-5 trajtime me dozë 200-400 gr/100 lit. uje ose 2-4 kg/dynym.

LULESHTRYDHE: Për ushqimin gjethor përdoret me dozën 200-400 gr/100 lit. uje kur fruti fillon zbardhjen. **Me sistemin e ujitjes me pika** : Doza rekomanduar është 2-4 kg/dynym. **NE VRESHTA, BORONICE, MANAFERRA DHE MJEDER**: **Si ushqyes gjethor**, me dozë 5 deri në 10 kg/ha ose me përqendrim 200-400 gr/100 lit. uje. **NE FRUTIKULTURE**: **Si ushqyes gjethor** përdoret me dozën 200-400 gr/100 lit. uje (5-10 kg/ha). **Me ujitje me pika** : me dozë 20-40 kg për hektar. **NE DUHAN**: Është bimë me kërkesa ndaj Potasit. **Në shtratin e mbjelljes** : Pas mbjelljes shtrati ujitet me solucion **NUTRI-LEAF 4-5-40®** me dozën 0.5 kg në 100 liter uje për 100 m² e pasua me vadi të me uje të bollëshe. **Gjate trapjantimit** : Përdoret 0.1 kg për 100 liter ujë duke ujitur fidanin pas mbjelljes. **NE KARROTE** : me **sperkatje gjethore** me dozë 500 gr/dynym duke filluar trajtimet me rritjen e bujeshmërisë ose formimin e frutrenjorit. **FIDANISHTA NE SERA**: Përdoret si ushqim gjethor suplementar në fidanishten e primeve e luleve në normën 500 gr/100 lit. uje duke sperkatur direkt mbi gjethet derisa solucionet të shkojnë në sistemin rrenjor. Përpara mbjelljes fidanat mund të banjëzohen në një solucion me 100 gr/10 lit. uje. Në serat me sistem sperkates në formë shiu fidanat sperkatën 2-3 herë në javë me 0.1%.

VEREJTJE PER PERDORIMIN : Përpunueshmëria: Përzihet me insekticidet dhe fungicidet të cilët janë në përdorim të gjërë. **KUJDES**: **NUK** përzihet me Grupin Dinitro, Bordolezin e pregatitur në fushë, Polisulfure, NitroKalcium ose materiale shumë alkaline. Në perzierje me produkte të tjerë **NUTRI-LEAF 4-5-40®** gjithmonë hidhet në depozitë si përbërës i fundit. Kur përdoret ujë shumë i ftohtë, përzihet disa minuta me shumë për të siguruar tretjen e plote të produktit. **SHENIM** : Përdorni këtë produkt në përputhje me praktikën e mira agronomike, të cilat përfshijnë përdorimin e pajisjeve përkatëse cilësore për të garantuar mbulimin uniform të gjethëve. Mos trajtoni kur temperaturat janë shumë të nxehta. Trajtimet duhet të bëhen në temperatura të moderuar vonë mbasditë dhe në kushte të tjera mjedisore të zonës të cilat nga përvoja juaj garantojnë efektivitetin e sperkatjes dhe rezultatin e dëshiruar. **RUAJTJA DHE MAGAZINIMI** : Produkti ruhet në ambalazh origjinal, në vende të fresketa dhe të thata në temperatura -5 / +50°C larg rezeve direkte të diellit. Periudha maksimale e ruajtjes në këto kushte është e pakufizuar. **MBAHENI LARG ARITJES PREJ FEMIJEVE.**

Duke qenë se **NUTRI-LEAF 4-5-40®** përdoret jashtë kontrollit tonë dhe duke pasur parasysh se ky produkt përmban elemente të rrezikut për njerëzit, kafshët dhe bimësinë, ne nuk japim asnjë garanci, të shprehur apo të nënkuptuar, për sa i përket efekteve negative në njerëz, kafshë dhe bimësi, kur ky produkt nuk përdoret në përputhje me udhëzimet e deklaruara në këtë etiketë.

NUTRI-LEAF 4-5-40® është markë e regjistruar e
Miller Chemical & Fertilizer, LLC

DISTRIBUTOR PER SHQIPERINE : AGROHELP SHPK
DURRES , CEL : 00355 692055 309/310

